

ISOFLEX-PU 500

Material i lëngshëm hidroizolues poliuretanic

Përshkrimi

ISOFLEX-PU 500 është një material i lëngshëm me një përbërës hidroizolues poliuretanic për taraca, i cili ofron:

- Rezistencë të përkryer mekanike, kimike, termike, UV dhe kundra konditave të këqija të motit, si rezultat i bazës të pastër të rrëshirës elastomerike, hidrofobe dhe poliuretanike.
- Një shtresë uniforme, elastike, hidroizoluese, të depertueshme nga avulli e cila nuk krijon bashkime ose lidhje.
- Ngjitje të shkëlqyer në nënshtresa të ndryshme, si betoni, llaçi i çimentos, druri dhe çdo lloj materiali hidroizolues.
- Mundësi përdorimi edhe në nënshtresa të paniveluara.
- Përshtatet për çati jeshile, Suitability for green roofs, vllaja, etj.
- Ofrohet në ngjyrën e bardhë dhe në ngjyra të tjera.
- Kur është zgjedhur një ISOFLEX-PU 500 me ngjyrë të errët si shtresa e ekspozuar, është e domosdoshme të mbulohet me një shtresë prej TOPCOAT-PU 720 në të njejtën ngjyrë.

Është çertifikuar me shënimin CE i cili e bën si shtresë mbrojtëse për sipërfaqet e betonit, sipas çertifikatës EN 1504-2. Numri i çertifikatës Nr. 2032-CPR-10.11.

Gjithashtu, produkti është kontrolluar sipas kërkesave të EAD 030350-00-0402 dhe është klasifikuar si: W3, S, TL4-TH4, P4 special, e cila do të thotë që ka jetëgjatësi pune 25 vjet nën konditat më të këqija të kontrollit, të cilat përkufizohen nga standarti në lidhje me peshat e përdorimit (P4), zona klimatike (S) dhe rezistenca ndaj temperaturave funksionimi të larta dhe të ulëta (TL4-TH4).

Raporti i Vlerësimit Teknik – SOCOTEC Nr.: 210568080000018, i vlefshëm deri më 31/12/2024. ISOFLEX-PU 500 është çertifikuar si rezistent ndaj rrenjëve, sipas UNE CEN/TS 14416 EX: 2014.

Fushat e përdorimit

ISOFLEX-PU 500 është ideal për hidroizolim:

- Për taraca dhe ballkone si një shtresë e ekspozuar hidroizoluese.
- Poshtë shtresës nën pllakat të kuzhinës, të banjave, të ballkoneve dhe të taracave, me kushtin që shtresa e fundit është spërkatur me rërë kuarcore.
- Nën izolimin termik të dyshemeve dhe të taracave.
- Në punë ndërtimore, si autostrada, pjesën e ecshme të urave, tunele, etj.
- Themele.
- Pllaka gipsi dhe çimentoje.
- Shtresa të vjetra bituminoze.
- Shkumë poliuretani.
- Në sipërfaqe metalike.

Të dhënat teknike

1. Vetitë e produktit në formë të lëgshme

Trajta:	pri-polimer poliurethani
Ngjyra:	e bardhë, gri, kafe e kuqërremtë
Densiteti:	1.39 kg/l
Viskoziteti:	4,000 ± 500 mPa·sec (+23°C)

2. Vetitë e shtresës të thatë

Zgjatja deri në këputje: (ASTM D 412 / EN 527-3)	> 500%
Rezistenca në tërheqje: (ASTM D 412 / EN 527-3)	> 8.0 N/mm ²
Fortësia sipas SHORE A:	75 ± 3
Padepërtueshmëria nga uji: (DIN 1048)	5 atm
Pasqyrimi i rrezeve të diellit (SR): (ASTM E903-96)	86%
Emetimi me infra të kuqe: (ASTM C1371-04a)	0.88
Treguesi i pasqyrimin të rrezeve të diellit (SRI) (ASTM E1980-01):	108
Kufijtë e temperaturës:	-40°C deri në +90°C

ISOFLEX-PU 500

Mbushja e plasaritjeve sipas:

EN 1062-7:

(Metoda A): ≥ 3.0 mm
(Kategoria A5 > 2.5 mm)

Raporti teknik

TR-013:05-2004 (-30°C): Kalon (gjerësia maksimale e plasaritjeve 1.5 mm)

Raporti teknik

TR-008:05-2004: Kalon (1000 cikle) (gjerësia maksimale e plasaritjeve 2.0 mm)

Sipas EAD 030350-00-0402:

Jetëgjatësia e pritur e punës:

W3 (25 vjet)

Zona klimatike:

S (e rëndë)

	I rëndë
Ekspozimi vjetor rezatues në sipërfaqen horizontale	≥ 5 GJ/m ²
Temperatura mesatare muajin më të nxehtë të vitit	$\geq 22^\circ\text{C}$

Temperatura minimale e sipërfaqes: TL4 (-30°C)

Temperatura maksimale e sipërfaqes: TH4 (+90°C)

Pesha e përdoruesit: P4

Kategoria	Pesha e përdoruesit	Shëmbuj aksesi
P1	E ulët	Pa akses.
P2	Mesatare	Me akses vetëm për mirëmbajtjen e çatisë.
P3	Normale	Me akses për mirëmbajtjen e fabrikës dhe të pajisjeve dhe të trafikut të këmbësorëve.
P4	E veçantë	Kopshte çatie, çati të kundërta, çati jeshile.

Sipas EN 1504-2:

Thithja kapilare: 0.01 kg/m²·h^{0.5}
(EN 1062-3, kërkesa e EN 1504-2: $w < 0.1$)

CO₂ depertueshmëria: Sd > 50m
(EN 1062-6)

Depertueshmëria nga avulli i ujit: Sd = 0.72m
(EN ISO 7783-2, e depertueshme, Class I < 5m)

Ngjitja: > 2.0 N/mm²
(EN 1542, kërkesa për sistemet fleksibël pa qarkullim: 0.8 N/mm²)

Vjetërsim artificial: E kalon (nuk shfaqen fluska, të çara ose shkëputje)
(EN 1062-11, pas 2000 orësh)

Ekspozimi ndaj zjarrit të jashtëm:

KATEGORIA
B_{çati} - t1*

(EN 13501-5)

*Me PRIMER-PU 100 si sistem. Raporti nr.: 17/15049-2325, pjesa 1, APPLUS Laboratories – LGAI, Spanjë.

Udhëzimet e përdorimit

1. Përgatitja e nënshtresës

Në përgjithësi, nënshtresa duhet të jetë e thatë (lagështia < 4%), e pastër, pa yndyrë, pa materiale të lira, pluhur, etj.

1.1 Nënshtresat e betonit

Çdo zgavër eksistuese në beton duhet të mbushet me materialin e duhur mbushës që më përpara.

Plasaritjet e thella mbi nënshtresën duhet të mbushen me mbushësit poliuretanic FLEX PU-30 S/50 S.

Betoni dhe sipërfaqe të tjera poroze me lagështi <4% duhet të trajtohen me astarin e veçantë PRIMER-PU 100, me konsum reth 200 g/m².

Sipërfaqet me nivel lagështie > 4% duhet të lyhen me astar special poliuretani, me dy përbërës, PRIMER-PU 140, me konsum 100-250 g/m².

ISOFLEX-PU 500

1.2 Nënshtrësasat e lëmuara dhe jopërthithëse

Nënshtrësasat e lëmuara dhe jopërthithëse, si dhe membranat bituminoze ose shtresat e vjetra hidroizoluese, duhet të lyhen me astarin epoksid me bazë uji EPOXYPRIMER 500, të holluar me ujë deri në 30% të peshës. Produkti aplikohet në një shtresë me furçë ose me rul.

Konsumi: 150-200 g/m².

Në varësi të kushteve të motit, ISOFLEX-PU 500 aplikohet brenda 24-48 orëve pas aplikimit të astarit, sapo niveli i lagështisë të bjerë nën 4%.

1.3 Nënshtrësasat metalike

Nënshtrësasat metalike duhet të jenë:

- Të thata dhe të pastra.
- Pa yndyrë, material të lira, pluhur, etj. që mund të pengojnë ngjitjen.
- Pa ndryshk ose gërryerje që mund të pengojnë ngjitjen.

Pas përgatitjes nëpërmjet fërkimit me furçë, me rërë etj. dhe pas pastrimit të plotë nga pluhuri, sipërfaqet metalike lyhen me shtresën epokside kundër gërryerjes EPOXYCOAT-AC në një ose dy duar. EPOXYCOAT-AC aplikohet me rul, furçë ose spërkatje. Shtresa (dora) e dytë bëhet pasi të jetë tharë dora e parë, por brenda 24 orësh.

Konsumi: 150-200 g/m²/shtresë.

Aplikimi i ISOFLEX-PU 500 duhet të bëhet brenda 24-48 orëve të ardhshme.

2. Aplikimi-Konsumi

Para aplikimit, rekomandohet përzierja e lehtë e ISOFLEX-PU 500, derisa të bëhet homogjen. Përzierja e tepërt duhet shmangur që të parandalohet bllokimi i ajrit në material.

a) Isolimi total në sipërfaqe

ISOFLEX-PU 500 aplikohet me furçë ose ryl në 2 shtresa. Shtresa e parë aplikohet 2-3 orë pas astarimit dhe ndërsa PRIMER-PU 100 ngjit akoma. Shtresa e dytë duhet të aplikohet në mënyrë transversale (përpjendikulare) pas 8-24 orësh, në varësi me konditat e motit.

Konsumi: 1.0-1.5 kg/m² në varësi me nënshtrësën.

Në rastin e plasaritjeve të dendura të shumëfishta në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që të përfordhet plotësisht membrana e ISOFLEX-PU 500 me shirita 100 cm të gjerë prej fibrash poliesteri (60 g/m² ose 120 g/m²), që duhet të mbivendosen me 5-10 cm. Dy tre-orë pas lyerjes, dora e parë e ISOFLEX-PU 500 aplikohet në një gjerësi prej 100 cm dhe ndërsa është akoma e njomë vendoset një shirit me fibra poliesteri.

I njëjti proces aplikimi ndiqet për pjesën e mbetur të sipërfaqes. Më pas, aplikohen edhe dy duar të tjera ISOFLEX-PU 500 në të gjithë sipërfaqen. Konsumi: > 2,50 kg/m², në varësi të llojit të nënshtrësës.

b) Isolimi lokal i plasaritjeve

Në këtë rast, astari aplikohet në nënshtrësë vetëm mbi plasaritjet, në një gjerësi prej 10-12 cm. 2-3 orë pas astarimit, shtrohet shtresa e parë e ISOFLEX-PU 500 dhe, ndërsa është akoma e njomë, ngjeshet sipas gjatësisë (të plasaritjes) një shirit me fibra poliesteri (60 g/m² ose 120 g/m²). Përfundimisht, dy shtresa ekstra ISOFLEX-PU 500 shtrohen mbi plasaritjeve, të cilat e mbulojnë krejt përfordimin.

Konsumi: > 250 g/m prej gjatësie plasaritje, në varësi të llojit të nënshtrësës.

c) Hidroizolimi nën pllakat

ISOFLEX-PU 500 shtrohet me furçë ose me ryl në dy shtresa.

ISOFLEX-PU 500 duhet të përfordhet lokalisht gjatë baskimeve dhe pjesëve ku bashkohet dysHEMEJA me muret, duke ngjeshur një shirit 10 cm të gjërë me fibra poliesteri (60 g/m² ose 120 g/m²) në shtresa e parë, sa është akoma e njomë. Pastaj, shtrohen dy ekstra shtresa me ISOFLEX-PU 500 gjatë plasaritjeve, duke mbuluar krejt përfordimin.

Pas aplikimit, shtresa përfundimtare, dhe ndërkohë që është akoma e njomë, shpërkatet me rërë kuarcore (Ø 0.3 - 0.8 mm). Rëra kuarcore duhet të jetë krejt e thatë.

Konsumi i rërës kuarcore: rreth 3 kg/m².

Pas 24 orësh, çdo kokrrizë e lirë duhet të largohet me një fshesë me vakuum me fuqi të madhe thithëse.

ISOFLEX-PU 500

Pllakat duhet të vihen me një ngjitës pllakash të modifikuar me polimer, si ISOMAT AK-22, ISOMAT AK-25, ISOMAT AK-ELASTIC, ISOMAT AK-MEGARAPID.

Veglat duhet të pastrohen me tretësin SM-28, ndërsa ISOFLEX-PU 500 është akoma i njomë.

Amballazhimi

ISOFLEX 500 ofrohet në bidona metalik prej 1 kg, 6 kg, 12 kg dhe 25 kg.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në kuti të mbyllura, në temperatura ndërmjet +5°C dhe +35°C në vende të mbrojtura nga rezet e diellit dhe ngrica.


Shënime


- Në rast aplikimi me spërkatje, mund të hollohet deri 10% vëllim me tretësin e vecantë SM-28, në varësi me konditat e motit.
- ISOFLEX-PU 500 nuk përshtatet për kontakt me ujë dhe pishinave të tratjuar në mënyre kimike.
- Temperatura gjatë aplikimit dhe fortësimit duhet të jetë ndërmjet +8°C and +35°C.
- Konsumi i ISOFLEX-PU 500 nuk duhet të teprtojë 750 g/m² për shtresë.
- Paket e pa hapura duhet të përdoren menjëherë sa hapen dhe nuk mund të magazinohen prapë.
- ISOFLEX-PU 500 është synuar vetëm për përdorim profesional.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/CE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "I", lloji SB është 500 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim ISOFLEX-PU 500 përmban maksimum 500 g/l VOC.

ISOFLEX-PU 500


ISOMAT S.A. 17 th km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece 15
ETA - 15/0206 EAD 030350-00-0402 DoP No.: ISOFLEX-PU 500 / 005-25 Roof slope: S1 to S4 External fire performance (EN 13501-5): B _{Roof} (t1) Reaction to fire EN (13501-1): NPA Dangerous substances: see section 3.2 Water vapor diffusion resistance factor μ: ≈ 1800 Watertightness: Watertight Resistance to wind loads: ≥ 50 kPa Resistance to mechanical damage: P1 to P4 Working life: W3 (25 years) Lowest surface temperature: TL4 (-30°C) Highest surface temperature: TH4 (90°C) Working life according to the resistance to ageing media (heat and water): W3 (25 years) Resistance to UV radiation in the presence of moisture: Moderate and Severe climatic Resistance to plant roots: NPA Maximum tensile strength /elongation (5°C): 6.8 MPa / 43.9% (Dynamic indentation P4) Maximum tensile strength /elongation (30°C): 7.1 MPa / 39.4% (Dynamic indentation P4) Effects of day joints: 830 KPa Slipperiness: NPA


2032
ISOMAT S.A. 17 th km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece 12
2032-CPR-10.11 DoP No.: ISOFLEX-PU 500/1810-01 EN 1504-2 Surface protection products Coating Permeability to CO ₂ : Sd > 50m Water vapor permeability: Class I (permeable) Capillary absorption: $w < 0.1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0.5}$ Adhesion: $\geq 0.8 \text{ N/mm}^2$ Artificial weathering: Pass Reaction to fire: Euroclass F Dangerous substances comply with 5.3

ISOMAT S.A.
 BUILDING CHEMICALS AND MORTARS
ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:
 17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
 P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
 Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 576 029
www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu